

FTESË PËR OFERTË

Data: 01.12.2024

Prishtinë

Numri i referencës: 004-2024-LDK

1. Autoriteti Kontraktues: Lidhja Demokratike e Kosovës

2. Lënda e Kontratës: "Shfrytëzimi i hapësirave për marketing nëpër bilborde, LED ekrane, pritore të autobusëve, megaboard dhe format të tjera të reklamimit të jashtëm në qytete të ndryshme të Kosovës, për promovimin e fushatës zgjedhore të Lidhjes Demokratike të Kosovës."

3. Procedura e përdorur: E hapur

4. Kushtet për ofertim:

- Kompanitë ofertuese duhet të dorëzojnë dokumentacionin e nevojshëm ligjor, përfshirë certifikatën e regjistrimit të biznesit dhe certifikatën e regjistrimit për TVSH.
- Të gjitha çmimet e ofruara duhet të përfshijnë të gjitha taksat e aplikueshme.
- Çmimet duhet të kuotohen në Euro.
- Oferta duhet të përfshijë një plan të detajuar të hapësirave reklamuese të ofruara (lokacionet, numri i bilbordeve/ekraneve, kohëzgjatja e shfaqjes etj.).
- Të jepet garancion për cilësinë e shfaqjes dhe përkushtim në realizimin e afateve dhe standardeve të kërkuara.
- Lidhja Demokratike e Kosovës rezervon të drejtën që të anulojë ofertën dhe/ose të ndryshojë karakteristikat e tenderit dhe t'i ftojë sërish kompanitë për të paraqitur ofertat e tyre.
- Dokumentacioni i pakompletuar nuk do të merret parasysh.

Dorëzimi i ofertave:

Ofertat e mbyllura në pliko duhet të dorëzohen në Zyrën Qendrore të Lidhjes Demokratike të Kosovës, në qendër, nga data 01.12.2024 me së voni deri më 27.12.2024, në orën 16:00.